VENDIM
Nr. 55, datë 28.10.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN SHA
(ndryshuar me vendimin nr. 391, datë 21.10.2021)

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan (UK Elbasan), me shkresën nr. 1764 prot., datë 30.7.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor të UK Elbasan në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
a) shoqëria UK Elbasan ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 157 349 banorë në Bashkinë Elbasan;
b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Julian Doçi, zotëron diplomë master në "Inxhinieri hidroteknike", marrë në mars të vitit 2011 dhe ka 8 vite përvojë në profesion.
4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Elbasan, të:
a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.
5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Elbasan, rekomandon:
- Shoqëria UK Elbasan duhet të aplikojë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me një strukturë të re tarifore.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Elbasan është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a., me NUIS L43121201L në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura. [1]

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – z. Luan Dervishi;

b) drejtues teknik – z. Julian Doçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a., është:

Bashkia Elbasan.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4- vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

[1] Me vendimin nr. 55, datë 28.10.2019 është vendosur:
1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 55, datë 28.10.2019, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Elbasan", bëhet ndryshimi si më poshtë:
"Drejtues ligjor – Leli Kaja";
"Drejtues teknik – Lulzime Dama".